



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK



Nr.4 Prot.

Tepelenë, më 30.03.2026

PROÇES – VERBAL
(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 30.03.2026, ora 11:00 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 26.02.2026.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shkurt 2026.”
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shkurt 2026”.
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e parshikimeve afatmesme të të ardhurave dhe taveve përgatitore të PBA 2027- 2029.”
6. **Projektvendim:** “Për miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Tepelenë në programin për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë.”
7. **Projektvendim:** “Për dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim, në favor të qendrës “ACEG”, një pjesë të objektit publik Shkolla 9-vjeçare “Asim Zeneli”, fshatin Progonat, Bashkia Tepelenë, si dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim.”
8. **Projektvendim:** “Për miratimin e marrëveshjes tip me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.”
9. **Projektvendim:** “Për vendosjen e eshtrave të Dëshmorit të Atdheut, Mirjan Dino Hoxha, në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut të Tepelenës.”
10. **Projektvendim:** “Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Tepelenë.”

11. Çështje të tjera.

12. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Marin pjese në mbledhje këshilltaret;

- Arben Gumeni
- Dino Selimi (ora 11.20)
- Matilda Çela
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani
- Ilir Haska
- Besnik Mece
- Ditar Hodaj
- Besnik Maca
- Latif Kacaj
- Mirela Varfi (ora 11.45)

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë:

- Spiro Kora
- Julinda Karteri
- Arta Shaha
- Lumturi Dervishi
- Festime Elezi
- Rovena Mullaraj

Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni, përshëndet të pranishmit dhe hap mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin mars, paraqet rendin e ditës për shqyrtim dhe miratim, jeni dakord me rendin e ditës ta hedhim në votim.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota pro (9): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani. **Vota kundër** nuk ka, **vota abstenim** nuk ka.

Pika e dytë e rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 26.02.2026.

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje në lidhje me procesverbalet e mbledhjeve të kaluara, jo, hedhim në votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

Vota pro (9): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani. **Vota kundër** nuk ka, **vota abstenim** nuk ka.

Pika e tretë e rendit të ditës: Projektvendim: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fondin 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shkurt 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, Komisioni është mbledhur dhe është njohur me materialin për dhënien e ndihmës ekonomike me fondin 6% për muajin shkurt 2026, kjo pike erendit te dites nuk ka ndryshime nga muaji i kaluar, trajtohen me ndihmë ekonomike fondi 6% 10 familje me fond 43.858 lekë, propozoj miratimin e projektvendimit.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

Vota pro (9): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

Pika e katërt e rendit të ditës: Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin shkurt 2026”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, Për muajin shkurt do të trajtohen 94 familje nga fondi i Bashkisë, nuk ka ndryshime nga muaji i kaluar, propozoj hedhjen në votim të projektvendimit.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

Vota pro: (9). Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

Pika e pestë e rendit të ditës Projektvendim: “Për miratimin e parshikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavaneve përgatitore të PBA 2027- 2029.”

Fjalën e merr z. Spiro Kora, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar

I nderuar Kryetar i Këshillit,
Të nderuar këshilltarë,

Në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, paraqesim për miratim projektvendimin për vlerësimin e të ardhurave dhe përcaktimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve sipas programeve buxhetore.

Buxheti total dhe rritjet vjetore:

- Viti 2026: 376,000,000 lekë
- Viti 2027: 385,000,000 lekë (rritje 2.4%)
- Viti 2028: 395,000,000 lekë (rritje 2.3%)

- Viti 2029: 406,000,000 lekë (rritje 3.0%)

Struktura e të ardhurave:

- Të ardhurat e veta: mesatarisht rreth 18%
- Transfertat nga buxheti i shtetit: rreth 82%

Kjo tregon se financat e bashkisë mbeten kryesisht të varura nga transfertat shtetërore.

Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik:

- Paga dhe sigurime shoqërore: rreth 58–62%, të ndikuara nga rritjet e pagave
- Shpenzime korente: rreth 18–20%, për funksionet dhe shërbimet publike
- Shpenzime kapitale: rreth 10–12%
- Mbrojtja civile: rreth 4% e buxhetit

Buxheti social zë një vend të veçantë, duke synuar mbështetjen e shtresave në nevojë dhe grupeve vulnerabël.

Këto janë tavanet buxhetore, të cilat pas miratimit do t'u shpërndahen ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për paraqitjen e kërkesave të tyre.

Dokumenti i përgatitur do të dërgohet në Ministrinë e Financave deri më 1 qershor 2026 për vlerësim dhe mendim.

Gjithashtu, do të zhvillohen dëgjesa publike gjatë muajve qershor–korrik për përgatitjen e dokumentit të parë të PBA 2027–2029, me qëllim sigurimin e pjesëmarrjes së komunitetit dhe grupeve të interesit.

Dokumenti i parë pritet të miratohet në korrik 2026, ndërsa gjatë muajve tetor–nëntor do të zhvillohen sërish dëgjesa publike deri në miratimin përfundimtar të PBA 2027–2029 dhe buxhetit të vitit 2027, brenda datës 25 dhjetor 2026.

Tavanet përgatitore janë ndërtuar mbi këto projeksione, duke ruajtur balancën ndërmjet detyrimeve operative dhe investimeve, si dhe duke garantuar një qasje të qëndrueshme dhe realiste në menaxhimin e financave vendore.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju ftoj për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektvendimi.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë; Në cilësinë e Kryetares së Komisionit të Ekonomisë, ju informoj se projektvendimi për vlerësimin e të ardhurave dhe përcaktimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve për periudhën 2027–2029 është shqyrtuar me kujdes nga Komisioni. Gjatë shqyrtimit janë analizuar parashikimet e të ardhurave, të bazuara në performancën financiare të viteve të mëparshme, si dhe janë vlerësuar tavanet e propozuara të shpenzimeve në funksion të ruajtjes së stabilitetit fiskal dhe mbështetjes së prioritetëve zhvillimore të bashkisë. Komisioni i Ekonomisë dhe Financave vlerëson se ky projektvendim

është i bazuar në një qasje realiste dhe të qëndrueshme financiare, dhe rekomandon miratimin e tij nga Këshilli Bashkiak.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

Vota pro (9): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani. **Vota kundër nuk ka.vota abstenim nuk ka.**

Projektvendim: “Për miratimin e bashkëfinancimit të Bashkisë Tepelenë në programin për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë.”

Fjalën e merr z. Spiro Kora, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar

Në bazë të treguesve për vitin 2025, të ardhurat për frymë kanë arritur në vlerën 7,024 lekë për frymë. Sipas referencave të programeve të strehimit për vitin 2026, për kategorinë me të ardhura nga 6,000 deri në 8,000 lekë për frymë, subvencionimi për strehimin përbëhet nga 60% financim nga buxheti i shtetit dhe 40% nga qeverisja vendore.

Matilda; Niveli i financimit nga njësia vendore ka pësuar rritje, duke kaluar nga 20% në 40%.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

Vota pro (9): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani. **Vota kundër nuk ka.vota abstenim nuk ka.**

Projektvendim: “Për dhënien në përdorim pa kundërshtim, në favor të qendrës “ACEG”, një pjesë të objektit publik Shkolla 9-vjeçare “Asim Zeneli”, fshatin Progonat, Bashkia Tepelenë, si dhe miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit që do të nënshkruhet për këtë qëllim.”

Kryetari Këshillit :Eshte paraqitur kërkesa nga një shoqëri jofitimprurëse për marrjen në përdorim të një objekti në pronësi të Bashkisë Tepelenë. Ky objekt do të shfrytëzohet për zhvillimin e aktiviteteve edukative, sportive, kulturore dhe mjedisore në shërbim të fëmijëve dhe të rinjve. Bashkia Tepelenë të mundësojë dhënien në përdorim të një pjese të objektit të shkollës 9-vjeçare “Asim Zenali”, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për një periudhë të përcaktuar. Ju ftoj ju si keshilltar ta votoni eshte ne te mire te komunitetit.

Ditar: Kjo është verore?

Kryetari i Këshillit: Propozohet që t’i jepet leje shoqërisë për të investuar në ambientet e shkollës.

Juli: Me materialin përkatës jeni njohur më parë. Do të bëj një rezymë të shkurtër lidhur me këtë shoqatë jofitimprurëse.

Në fillim të vitit 2026 është paraqitur shprehja e interesit nga kjo shoqatë. Kryetari i Bashkisë ka ngritur një grup pune, i cili ka kryer një analizë të thelluar të gjendjes fizike të shkollës 9-vjeçare “Asim Zeneli”, në fshatin Progonat. Detyra e këtij grupi ka qenë përgatitja e materialit për shqyrtim në Këshill. Në material, komisioni ka paraqitur një relacion të detajuar, ku theksohet se objekti është pasuri e Bashkisë Tepelenë dhe është në funksion të veprimtarisë arsimore. Godina është funksionale për procesin mësimor, por është e ndarë funksionalisht: një pjesë është në përdorim, ndërsa ambientet e katit të dytë dhe të tretë janë të pashfrytëzuara dhe po amortizohen nga mos përdorimi. Sipas konkluzioneve të komisionit, këto ambiente nuk paraqesin rrezik të dukshëm. Është kërkuar gjithashtu informacion nga Zyra Vendore e Arsimit Tepelenë, me shkresën nr. 367, datë 17.02.2026, për dhënien e opinionit mbi përdorimin sezonal të një pjese të ambienteve për organizimin e një kampi veror edukativ. Në përgjigje, me shkresën nr. 152, datë 23.02.2026, Zyra Vendore e Arsimit Tepelenë–Memaliaj ka shprehur dakordësinë për shfrytëzimin e ambienteve të katit të dytë, ku aktualisht nuk zhvillohet mësim apo veprimtari tjetër shkollore. Gjithashtu është theksuar se këto ambiente po amortizohen me shpejtësi, duke rrezikuar në të ardhmen edhe mjediset funksionale të katit të parë. Rëndësia e këtij projekti qëndron në interesin publik për Bashkinë Tepelenë. Projekti kontribuon në gjallërimin social dhe ekonomik të zonës, si dhe në përdorimin më efikas të pasurive publike. Veprimtaria do të zhvillohet pa qëllim përfitimi dhe në interes të komunitetit lokal. Cfarë do të përfitoj bashkia Tepelenë nga kjo iniciative ;

- rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të papërdorura të objektit publik
- zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe sociale për të rinjtë
- promovimin e zonës së Kurveleshit si destinacion i turizmit të natyrës
- përfshirjen e komunitetit lokal në aktivitete ekonomike dhe sociale
- krijimin e mundësive të punësimit sezonal për banorët e zonës.

Përdorimi i objektit kufizohet në ambjentet e paperdoruar të shkollës dhe nuk cënon procesin mesimor.

Çdo investim i kryer nga Përdoruesi në objekt mbetet pronë e Bashkisë Tepelenë pas përfundimit të afatit të përdorimit, pa të drejtë kompensimi.

Veprimtaria zhvillohet pa qëllim fitimi, në përputhje me statutin e organizatës ACEG dhe në interes të komunitetit lokal.

Çdo investim i kryer nga Përdoruesi në objekt mbetet pronë e Bashkisë Tepelenë pas përfundimit të afatit të përdorimit, pa të drejtë kompensimi.

Veprimtaria zhvillohet pa qëllim fitimi, në përputhje me statutin e organizatës ACEG dhe në interes të komunitetit lokal.

Aktiviteti do të zhvillohet në një periudhë të caktuar, konkretisht gjatë 3 muajve të verës. Gjithashtu, u nënvizua se në çdo moment, nëse objekti do të kërkohet nga Bashkia për arsye të funksionit arsimor, marrëveshja do të ndërpritet nga ana e Bashkisë. E rëndësishme që diskutojmë në përcaktimin e një afati të përshtatshëm, duke marrë në konsideratë edhe investimin që do të kryejë shoqata dhe nevojën për dakordësi mbi kushtet e marrëveshjes.

Kryetari i Këshillit: Ky projekt është në interes të komunitetit të diskutojmë për afatin kohor të dhënies në përdorim.

Juli: Nëse i referohemi legjislacionit për dhënien në përdorim të pasurive, Bashkia mund të vendosë një afat deri në 15 vjet. Megjithatë, duhet të përcaktojmë një afat të arsyeshëm, duke marrë parasysh nivelin dhe ecurinë e investimit.

Kryetar i Këshillit: Sa të jetë afati?

Juli: Mbi 5 vjet.

Matilda: Në komision kemi diskutuar edhe vlerën që do të kishte kjo pronë nëse do të jepej me qira, si dhe nivelin e investimit nga organizata. Duke qenë se një investim, p.sh. deri në 5,000 euro, nuk justifikon një afat të shkurtër 3-vjeçar, mendoj që një afat 8–9 vjet do të ishte më i arsyeshëm.

Kryetari i Këshillit: Propozimi është për një afat 8–9 vjet.

Miftar: Propozoj 8–9 vjet.

Kryetari i Këshillit: Bëhet fjalë për një investim pa pagesë qiraje.

Juli: Subjekti ka paraqitur shprehje interesi, vendimmarrja i takon Këshillit.

Kryetari i Këshillit: Hedhim në votim propozimin për një afat 9-vjeçar, së bashku me miratimin e marrëveshjes.

Vota pro (10): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Dino Selimi. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

Projektvendim: “Për miratimin e marrëveshjes tip me Këshillin e Qarkut Gjirokastrë.”

Juli: Kjo është një iniciativë e Këshillit të Qarkut, e cila vlerësohet si shumë e rëndësishme. Ajo mbështetet në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht në nenet 31, pika 2 dhe 22, pika 3, ku parashikohet se, në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk disponojnë fonde ose mjete të mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u ofron mbështetjen e nevojshme financiare. Gjithashtu, qarku ushtron funksionet që i delegohen nga një ose disa bashki brenda territorit të tij, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet

palëve. Kjo është një marrëveshje tip e miratuar nga Këshilli i Qarkut, dhe sot kemi detyrimin ta shqyrtojmë dhe ta miratojmë, me qëllim nënshkrimin e saj me Këshillin e Qarkut, për ushtrimin e kompetencave të deleguara nga pushteti qendror.

Mbështetja financiare në kuadër të kësaj marrëveshjeje do të realizohet në disa fusha kryesore, si:

- infrastruktura dhe shërbimet publike;
- shërbimet sociale;
- kultura;
- mbrojtja e mjedisit.

Nga diskutimet me Këshillin e Qarkut është arritur dakordësia për financimin e disa projekteve në interes të Bashkisë Tepelenë dhe qytetarëve të saj, si:

- rikonstruksioni i Muzeut Historik;
- ndërhyrje në qendra kulturore;
- zhvillimi i disa qendrave në fshatra;
- organizimi i festivalit të përvitshëm “Bylbylenjtë e Tepelenës”.

Ditar: Në akt-marrëveshje, neni 4 “Dispozita të përgjithshme” parashikon që kjo marrëveshje mund të ndryshohet ose përmirësohet në çdo kohë, me vullnetin e lirë të palëve. Propozohet të shtohet formulimi: me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Kryetari i Këshillit: Të hidhet në votim miratimi i akt-marrëveshjes, së bashku me ndryshimin e propozuar.

Vota pro (10): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Dino Selimi. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

Projektvendim: “Për vendosjen e eshtrave të Dëshmorit të Atdheut, Mirjan Dino Hoxha, në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut të Tepelenës.”

Ditar: Është marrë vendimi për statusin e dëshmorit.

Arta: Po.

Kryetari i Këshillit: Të hidhet në votim.

Vota pro (10): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Dino Selimi. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

Projektvendim: “Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Tepelenë.”

Juli: Jeni njohur me projektvendimin për Programin e Transparencës. Ky projektvendim është hartuar në bazë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, si dhe në përputhje me udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit. Hartimi i këtij programi vjen si domosdoshmëri, pasi në muajin mars 2026 përfundon afati i Programit të Transparencës aktual, i cili është miratuar më parë me vendim të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Tepelenë. Qëllimi i këtij projekt-akti është miratimi i Programit të Transparencës, si një instrument i domosdoshëm për garantimin e të drejtës së publikut për informim dhe për rritjen e transparencës në veprimtarinë e Bashkisë Tepelenë. Programi i Transparencës përcakton kategoritë e informacionit që duhet të publikohen në mënyrë proaktive në faqen zyrtare të bashkisë, mënyrën e publikimit të tyre, si dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e këtij informacioni.

Nëpërmjet këtij projekt-vendimi synohet:

- rritja e aksesit të qytetarëve në informacion publik;
- përmirësimi i komunikimit ndërmjet administratës dhe komunitetit;
- forcimi i llogaridhënies dhe transparencës institucionale;
- përmbushja e detyrimeve ligjore në fushën e të drejtës së informimit.

Miratimi i këtij programi është një detyrim ligjor për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar, jo më vonë se data 31 mars 2026.

Projekt-vendimi nuk ka ndikim financiar shtesë në buxhetin e bashkisë, pasi zbatimi i tij realizohet nga strukturat ekzistuese administrative.

Në përfundim, projekt-akti vlerësohet i domosdoshëm dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, ndaj propozohet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Tepelenë.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

Vota pro (10): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani, Dino Selimi. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

Cështje të tjera

Kryetari i Këshillit: Kemi dy çështje për shqyrtim: një emërtim rruge dhe një kërkesë për dhënie të titullit “Qytetar Nderi”.

Për emërtimin e rrugës, bëhet fjalë për një rrugë pranë spitalit të vjetër. Kush ka propozime?

Vladimir Bakiaj: Në atë zonë më parë ka qenë poligoni, ndërsa para tij ka ekzistuar edhe mulliri i vjetër.

Kryetari i Këshillit: Është përgatitur projektvendimi për emërtimin e rrugës i cili u diskutua dhe në komision. Ne duam emërtimin u paraqiten dy propozime: Rruga e Poligonit, dhe Rruga e Mullirit të Vjetër.

Ditar: Rruga të mund të mbajë edhe një emër në nder të një personi me kontribut për qytetin e Tepelenës.

Kryetari i Këshillit: Për vendosjen e emrit të një personi kërkohet më parë dakordësia e familjarëve. Në këto kushte, propozohet të zgjidhet një nga alternativat, Rruga e Poligonit” ose Rruga Mullirit I Vjetër.

Rruga e mullirit të vjetër, hidhet në votim miratohet

Vota pro (10): Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Vladimir Bakiaj, Besnik Maca, Esmeralda Bishani., **Dino Selimi Vota kundër nuk ka. vota abstenim** nuk ka.

Kryetari i Këshillit: Ka ardhur një kërkesë për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” pas vdekjes për **Adrian Hana**, i rënë në krye të detyrës. Kërkesa është paraqitur nga **Shoqata Kulturore Labëria**. Këshill ja delegon bashkisë që ta shqyrtojë kërkesën dhe ta paraqesë për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak.

Ditar: Ky rast të konsiderohet si një rast i veçantë i rënë në krye të detyrës. Mund të propozohet edhe për titullin “Dëshmor i Atdheut”.

Juli: Kjo procedurë nuk vendoset nga ne kërkesa dërgohet te Këshilli i Qarku, dhe Qarku e përcjell më tej te Ministria e Mbrojtjes për vlerësim dhe miratim.

Kryetari i Këshillit: Ka ardhur një kërkesë nga znj. Fatime Prasta, banore e fshatit Dukaj, Njësia Administrative Qendër, për rikonstruksionin e soletës dhe të çatisë së banesës së saj. Kjo kërkesë të ishte parashtruar më parë gjatë programit të aplikimit. Si këshilltarë të zonës, ju duhej ta kishit informuar banorët për të aplikuar në atë kohë.

Juli: Bashkia Tepelenë ka bërë disa njoftime gjatë periudhës së aplikimeve, njoftime para mbylljes së afatit të aplikimit.

Kerkese nga Z. Flamur Shehu, banor i lagjes Kala, Bashkia Tepelenë – kërkon ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara në pemtari nga punimet në lagje Kala. . Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë.

Kerkese nga Znj. Xheko Dervishi, banore e qytetit Tepelenë – kërkon ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë.

Kerkese nga Z. Aleks Shumeli, banor i Njesisë Administrative Qendër, fshati Kodër, kërkon ndihmë financiare për djegien e parcelës me ullinj dhe drurë frutore. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë.

Kerkese nga Z. Skënder Bega, banor i qytetit Tepelenë, kërkon ndihmë financiare pasi është i papunë. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë, pasi bëhet fjalë për familje në nevojë.

Kerkese nga Znj. Drita Dervishi, banore kërkon ndihmë financiare për arsye shëndetësore. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë.

Kerkese nga Znj. Arta Seferi, banore e qytetit Tepelenë, ka probleme me lagështinë në shtëpi dhe ka bërë disa ankesa. Bashkia ka intervenuar disa herë për këtë problem. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë për shqyrtim dhe zgjidhje.

Kerkese nga Kliton Elezi, fshati Lab, Martalloz, Njësia Administrative Lopës, ka raportuar se i është bllokuar rruga nga z. Fatjon Elezi dhe nuk lejohet të shkojë në banesë dhe parcelë. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë për zgjidhje.

Kerkese nga Z. Imer Elezaj, fshati Lab, Martalloz, Njësia Administrative Lopës, ka të njëjtin problem si më sipër. Kërkesa delegohet te zyra përkatëse e Bashkisë për zgjidhje.

Juli: Secila kërkesë duhet të plotësohet plotësisht dhe dosja e saj të jetë e kompletuar para se të vijë për miratim në Këshill.

Mbyllet mbledhja ora 12.00

SEKRETARI KËSHILLIT
Valbona ÇELA



KRYETARI KËSHILLIT
Arben GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË-PREZENCA E KËSHILLTARËVE
MBLEDHJA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË
Datë: 30.03.2026

Në mbledhjen e zhvilluar më datë 30.03.2026 morën pjesë këshilltarët si më poshtë:

Nr	Emër	Mbiemër	Neneshkrimi
1	ARBEN	GUMENI	
2	MATILDA	ÇELA	
3	DINO	DELIMI	
4	MIRELA	VARFI	
5	MJAFTONI	ZERAJ	
6	ESMERALDA	BISHANI	
	BESNIK	MAÇA	
8	LATIF	KAÇAJ	
9	MIFTAR	META	
10	ILIR	HASKA	
11	MARSELA	BALILI	
12	MARIOS	JORGO	
13	DITAR	HODAJ	
14	VLADIMIR	BAKIAJ	
15	VLADIMIR	GJONÇA	